



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. ____ prot.

Elbasan, më _____.____.2022

Web: Bashkisë Elbasan _____

ELBASAN

Televizioni lokal :

ELBASAN

Zyrës së Informacionit

KËTU

Lënda: Njoftim

PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SIPAS VKM-së
Nr.179, datë 26.02.2020

Në zbatim të VKM-së nr.179 datë 26.02.2020 " Për Rregullat, Kushtet dhe Procedurat e Privatizimit të Banesave që Kanë Qenë Subjekt i Ligjit nr.7652 datë 23.12.1992,"Për Privatizimin e Banesave Shtetërore", dhe të ligjit nr.9321 datë 25.11.2004,"Për Privatizimin e Banesave dhe Objekteve të kthyer në Banesa, të ndërtuara me fondet e Shoqërive dhe të Ndërmarrjeve Shtetërore", (i ndryshuar) **njoftohen qytetarët** që posedojnë banesa ose objekte të kthyer në banesa të ndërtuara nga shteti, të cilat vijojnë të jenë në pronësi të shtetit e rezultojnë të paprivatizuara dhe të pa regjistruara në regjistrin kadastral të pasuri vetë paluajtshme, **kur këto banesa:**

a) kanë qenë objekt privatizimi sipas ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", por kanë mbetur pa u privatizuar nga familja që e ka poseduar me kontratë qiraje me ish-ndërmarrjet komunale banesa;

b- janë banesa të ndërtuara deri në 31.12.1999 dhe kanë qenë objekt privatizimi sipas ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", **të paraqesin brenda 90 ditëve kërkesën për fillimin e procedurave të privatizimit të banesës pranë Bashkisë Elbasan nga:**

a- Subjekti i pajisur me autorizim nga organet kompetente, ose në rast vdekjeje të trashëgimtarëve të tij;

b- Çdo person i autorizuar me prokurë nga subjekti i përcaktuar më lart.

- Kërkesa duhet të përmbajë :

i) Të dhënat personale të subjektit kërkues.

- ii) Të dhënat lidhur me banesën ose objektin e kthyer në banesë.
- iii) Datën e kërkesës dhe nënshkrimin e kërkuarit.

▪ Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

i) Kontrata e qirasë, akti i dhënies dhe i marrjes në dorëzim të banesës nga ish-ndërmarrja komunale banesa, ose autorizim nga ish-organet administrative publike që e kanë strehuar në atë banesë.

ii) Çertifikatë familjare e datës 1.12.1992 dhe çertifikatë aktuale familjare.

iii) Dëshmi e trashëgimisë, nëse ka ndërruar jetë subjekti i pajisur me autorizim.

iv) Prokurë nëse personi është ngarkuar për të kryer veprimet nga subjekti i pajisur me autorizim.

v) Dokument identifikimi i kërkuarit.

Aplikimi mund të paraqitet në rrugë postare, me adresë :Bashkia Elbasan, Lagjja“ Luigj Gurakuqi”,
Rruga “ 11 Nëntori”, (ish-konvikti i shkollës Pedagogjike) Elbasan ose pranë Zyrës së Informacionit
me Një Ndalesë, Bashkia Elbasan, brenda afatit të mësipërm.

Shënim:

Gjithashtu njoftohen të gjithë subjektet që kanë paraqitur kërkesë në Bashkinë Elbasan,për përfundimin e procedurës së privatizimit përpara daljes së këtij njoftimi, të paraqiten në Bashkinë Elbasan, për vijimin e procedurave, sipas korrespondencave shkresore përkatëse dhe ndryshimeve ligjore aktuale.

Ju faleminderit !

**KRYETARI
Gledian Llatja**

**Me urdhër porosi
zv/kryetari
Aulona Bylykbashi**